

VENDIM
Nr.44, datë 16.1.1997

**PËR NGRIRJEN E LLOGARIVE TË FONDACIONEVE PIRAMIDALE “XHAFERRI” DHE
“POPULLI”**

Meqë veprimtaria e fondacioneve “Xhaferri” dhe “Populli” rezultoi e mbështetur në formën piramidale të huamarrjes, për të mbrojtur interesat e depozituesve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngrirjen e llogarive të fondacioneve “Xhaferri” dhe “Populli” në të gjitha bankat tregtare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu bankat tregtare të ngrijnë edhe ato llogari, të cilat janë furnizuar me mjete monetare nga këto dy fondacione.

2. Mjetet monetare të ngrira sipas pikës 1 të deklarohen nga bankat brenda datës 2.2.1997 pranë Këshillit të Ministrave.

3. Mjetet monetare të ngrira do të shpërndahen në favor të popullsisë që ka depozituar pranë këtyre dy fondacioneve, sipas kriterëve që do të përcaktohen më vonë.

4. U rekomandohet organeve kompetente të mos bëjnë transaksione hipotekare për pasuritë e firmave që nuk likuidojnë klientët e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi